

6

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 15.12.2014

PËR: Gazmend Muhaxheri, Kryetari i Komunës së Pejës
Islam Husaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Pejës

LËNDA: KËRKESË PËR RYSHQYRTIMIN E VENDIMIT TË KOMUNËS SË PEJËS,
Vendimi nr. 463-7446/2011,

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë 02/2011, për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Aktgjykimin A. nr. 918/2013 të Gjykatës Themelore, Departamenti për Çështje Administrative të pranuar me datë 19.11.2014, pas shqyrtimit të vendimit të Kuvendit të Komunës së Pejës Nr. 463-7446 vlerëson se:


- Kuvendi i Komunës së Pejës, nuk ka kompetencë të merr vendime për kthimin e pronës së paluajtshme e cila pronë nuk është evidentuar në regjistrat e pronësisë së Komunës së Pejës.
- Bartja e pronës në emër të komunës së Pejës mund të bëhet vetëm pas marrjes së vendimit përfundimtar nga gjykata kompetente. Për këtë rast është iniciuar kontest pronësor pran Gjykatës Komunale në Pejë, e cila përmes Aktvendimit C.nr. 562/1 të datës 11.11.2011 ka caktuar masën e përkohshme të sigurisë deri në vendosjen përfundimtare të këtij kontesti. Bazuar në nenin 124 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës komunat janë të obliguara të zbatojnë vendimet gjyqësore.
- Vendimi nr. 463-7446/2001, i Kuvendit të Komunës së Pejës, nuk është pranuar për vlerësim të ligshmërisë konform procedurave të parapara me nenin 81.2 të Ligjit nr. 03/L-040 Vetëqeverisje Lokale, por pas adresimit të lëndës në gjykatën kompetente;

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 82 pika 2 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale *kërkon* nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës së Pejës të ndër marrin veprime konkrete që, Vendimi nr. 463-7446/2011 të rishqyrtohet brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim.

Me respekt,

Ljubomir Marić,
Ministër i MAPL-së

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së;
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 15.12.2014

ZA: Gazmend Muhaxheri, Gradonačelnik Opštine Peći
Islam Husaj, Predsedavajući Skupštine Opštine Peći

PREDMET: ZAHTEV ZA PONOVRNO RAZMATRANJE ODLUKE OPŠTINE PEĆI,
Odluka br.463-7446/2011,

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom određenim po zakonu za lokalnu samoupravu br.03/L-040, prilog XII vladine uredbe 02/2011, o poljima administrativne odgovornosti kancelarije premijera i ministarstva, kao i presude A. br. 918/2013 osnovnog suda odeljenja za administrativna pitanja dostavljene dana 19.11.2014, nakon razmatranja odluke br. 463-7446 skupštine opštine Peći, ceni da:

- Skupština opštine Peći, nema nadležnost za donošenje odluka za vraćanje nepokretne imovine, imovina koja nije registrovana u registarskim knjigama imovine opštine Peći.
- Prenošenje imovine u ime opštine Peći se može izvršiti samo nakon donošenja finalne odluke od strane nadležnog suda. O ovom slučaju, iniciran je imovinski spor u opštinskom sudu Peći, koja preko rešenja C.br. 562/1 dana 11.11.2011 je odredila privremenu meru bezbednosti do završne odluke ovog spora. Na osnovu člana 124 Ustava Republike Kosova, opštine su dužne da sprovede sudske odluke.
- Odluka br. 463-7446/2001, skupštine opštine Peći, nije dostavljena za procenu zakonitosti u skladu sa procedurama predviđenim po članu 81.2 zakona br.03/L-040 za lokalnu samoupravu, već nakon adresiranja predmeta nadležnom sudu.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, na osnovu člana 82 tačka 2 zakona za lokalnu samoupravu, *zahteva* od skupštine opštine/gradonačelnika opštine Peći da preduzmu konkretnu mere kako bi odluku br.463-7446/2011 ponovno razmotrili u roku od 30 dana nakon prijema zahteva za ponovno razmatranje.

S'poštovanjem,

Ljubomir Marić,
Ministar MALS-a

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Rukovodiocima Odeljenja MALS-a;
Arhivi MALS-a



Në bazë të nenit 11 dhe nenin 14 paragrafi 1. të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04.qershor 2008) dhe nenit 11. paragrafi 1. të Statutit të Komunës së Pejës, 01.Numër: 09 – 8103 datë: 29.shtator 2008, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 28.dhjetor 2011, pas shqyrtimit të Propozimit për marrjen e Vendimit mbi anulimin e Kontratës mbi bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të patundshmerisë ngast.kad.nr.687/4. Këshillit Komunal të LK.dhe KK.të SPS.-sit Pejë, si dhe bartjen e të drejtës së pronësisë në fjalë në trashigimtarin ligjor Komunal të Pejës, njëzërit muar këtë

V E N D I M

MIRATOHET propozimi i Drejtorisë për Çështje Pronësoro Juridike KK.Pejë, për anulimin - shfuqizimin e Kontratës Nr.03-466/134 dt.20.09.1991, mbi bartjen e të drejtës së pronës komunale në shfrytëzim ngast.kad.nr.687/4, në sipërfaqe prej 0.00,78 ha, në të cilën gjendet edhe lokali afanist, Këshillit Komunal të LK.dhe KK.të SPS.-sit, Pejë, mëqë ky subjekt nuk ekziston më dhe ta bejë bartjen e të drejtës së pronësisë në fjalë në trashigimtarin ligjor Komunal të Pejës.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Çështje Pronësoro Juridike e KK.Pejë.

Vendimi ti dërgohet: Drejtorisë për Çështje Pronësoro Juridike të KK.Pejë, MAPL.- Prishtinë, dhe një kopje i bashkangjitet Procesverbali nga takimi i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me date: 28.dhjetor 2011.

L.Numër: 463 – 7446/2011
Pejë, date: 28.dhjetor 2011.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL PEJË

K R Y E S U E S J A,
Dr.Arbëresha Ajdini Nallbani